



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr 858/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “Kema Company” SH.P.K, dhe Pro & Co Group” SH.P.K-Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, (Lot 1) iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Prishtinë”, më datën 13.11.2020, mori këtë:

## **V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit 616-20-2390-5-1-1, (Lot 1) iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Prishtinë”.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës për Lot 1, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1, (Lot 1) iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Prishtinë” dhe lënda të kthehet në **rivlerësim për Lot 1**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## AR SY ET IM

Operatori ekonomik ankues “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 26.10.2020 me nr. 858/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse” me nr. të prokurimit: 616-20-2390-5-1-1,(Lot 1) iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK-Prishtinë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 27, 28, 51, 56, 69, 60, 69, si dhe neni 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / Komuna Prishtine, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim me vlerë të madhe. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës në lotin 1.

Përgjigje në pretendimin ankimor (neni 113):

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK/ Komuna Prishtine fillimisht për lotin 1, të këtij aktiviteti të prokurimit kishte rekomanduar për dhënie OE “Bujar Shabani BI, me datën 15.09.2020 në vlerë prej 684, 724.85€, përderisa me datën 08.10.2020, publikon, korrigjimin e njoftimit mbi vendimin e AK-se, ku në lot 1, dhe rekomandohet për dhënie OE “Kema – Company” shpk & Pro & “Co Group” sh.p.k në vlerë prej 737,830.00€, përderisa në lot 4, OE “Bujar Shabani B.I”,(loti 4, sipas shkresave të lëndës të ngarkuara në e-prokurim, nuk është kontestuar nga OE).



Pretendimet tjera ankimore qe kane te bëjnë kundër operatorit ekonomik te rekomanduar për dhënie ne lotin 1, përkatësisht kontestohen kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, te cilat do ti trajtojmë ne mënyre te përgjithësuar. Si fillim kontestohen pajisjet e punës te prezantuara nga OE te rekomanduar ne lotin 1, te këtij AP, i njëjte, ku potencohet se ne lotin 1. OE i njëjtë përveç pasjeve tjera ne oferte ka prezantuar edhe pajisje ne emër te OE “Ekskavatori” te cilit kontrata i është dhënie ne lotin 4. (Për te gjitha lotët janë kërkuar pajisje teknike) Si prove se bashku me raport gjeni marrëveshjen e datës 13.07.2020.

Pretendimi tjetër ka te beje me punëtoret e deklaruar ne ATK, përkatësisht potencohet se nuk janë prezantuar 30 punëtor. OE i njëjte ka aplikuar ne grup/konzorcium dhe sipas deklarave për punëtoret e prezantuar, rezulton qe te dy anëtalet e grupit e mbulojnë kërkesën e AK-se, për minimumin 30, punëtoret e kërkuar. Përderisa lidhur me librezën e qarkullimit, sipas numrit te regjistrimit 05-492-AK, përmes kërkesës nuk është aplikuar si kërkesë nga AK, validiteti i qarkullimit rrugor, ne te njëjtën libeze përshkrimi i automjetit është “automjet special”, ndërsa tek lista e pasjeve te prezantuara përshkruhet edhe Cisterne e ujit, për te cilin nuk mund te vlerësojmë nëse mjete është cisternë e ujit apo jo. Si prove bashkangjitur gjeni deklaratat e ATK-se, te prezantuara ne oferte. Pretendimet tjera ankimore kane te bëjnë kundër stafit profesional, përkatësisht kundrejt, znj Saxhide Ajdini, dhe Hajrulla Prenaj. AK përmes kërkesës se dosjes se tenderit për lot 1 dhe 7, kundrejt projekt menaxherit ka kërkuar variante te përvojës se punës 5 dhe 3 vite përvoje pune. Është kërkuar edhe staf tjetër me përvojë nga dy vite pas diplomimit. Znj. Ajdini, e kontestuar nga ankuesi rezulton qe e njëjta studimet i ka përfunduar me datën 12 prill 2018, ku ka marr titullin Bachelor i ndërtimtarisë, programi studimor –Konstruktiv. Për loti 1, AK kundrejt inxhinierëve ka kërkuar qe te njëjtit si dëshmi dokumentare te prezantojnë CV, diplome, kontratat e punës dhe referenca për punët e mëparshme. Kundrejt znj Ajdini, është prezantuar kopja e diplomës, kontratës dhe CV. Përderisa kundrejt z. Hajrualla Preniqi kopja e diplomës, me kualifikim bachelor i trafikut rrugor dhe transportit, si dhe CV. Për te njëjtit nuk janë prezantuar dëshmi – Referenca për punët e kaluara siç është kërkuar nga AK. Po ashtu parashtruesi i ankesës konteston edhe marrëveshjen e bashkëpunimit – Furnizim me beton te lidhur nga “Kema Company” sh.p.k me “Toni Compani”sh.p.k, përkatësisht kontestohet marrëveshja pasi qe nuk posedon date te lidhjes se marrëveshjes, për te cilat AK, përgjatë vlerësimit te ofertave ka mundur ti sqaroj bazuar ne LPP. Përfundimisht sipas asaj qe u përshkrua si me larte, propozimi ynë për AK, është qe lënda te kthehet ne ri-vlerësim, me qellim qe te pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave, përkatësisht te vet vlerësohet nëse me variante te kërkesave te kualifikimit mund te kemi vlerësim real, bazuar ne dispozitat ligjore për prokurim publik ne përgjithësi dhe ne veçanti nenin 59.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht a bazuar, te anulohet propozimi për dhënie ne dhe loti 1, te kthehet ne Ri vlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 05.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 06.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te nderuar: konfirmojmë pranimin e ekspertizës ,deklarojmë se nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit, pasi qe eksperti nuk dhënë mendim, sqarim apo rekomandim për asnjë nga pretendimet e ankuesit, por vetëm ka bere një përshkrim te pretendimeve dhe ne fund një mendim qe aktiviteti të kthehet në rivlerësim. Pra nuk ka as një sqarim se ne atë proces çka duhet te trajtohet si pretendim i bazuar apo i pa bazuar.

Operatori Ekonomik "Sallahu" SH.P.K-Kaçanik me datë: 06.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Nga:	"SALLAHU" Sh.p.k Kaçanik
Për:	Organi Shqyrtues i Prokurimit
Data:	06.11.2020
Lënda:	Përgjigje rreth Raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me Ankesën numër 858/20 të datës 26.10.2020

Të nderuar,

Me datë 04.11.2020 kemi pranuar raportin e Ekspertit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me Ankesën nr 858/20 të datës 26.10.2020, për aktivitetin e prokurimit; " Ndërtimi i rrugëve në pjesët rurale me infrastrukturë përcjellëse" me nr.të prokurimit 616-20-2390-5-1-1 (Lot 1) të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Prishtinë, ndaj të cilëve kemi parashtruar ankesë sipas dispozitave ligjore, dhe bazuar në kërkesën nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për përgjigje lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, Kompania Sallahu Sh.p.k deklaron: Pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, dhe të anulohet propozimi për dhënie të kontratës për LOT 1, si dhe qëndrojmë pranë të gjitha pikave të Ankesës me nr. 858/20 të datës 26.10.2020. Duke pasur parasysh që edhe eksperti ka konstatuar që lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim që të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave në përputhje me nenin 59 të LPP-së, ndërsa me gjetjet e ekspertizës pajtohemi pjesërisht ,duke pasur parasysh që në ankesën me nr. 858/20 ne kemi parashtruar numër të madh të argumenteve dhe provave lidhur me parregullsitë që e kanë përshkruar procesin e vlerësimit të ofertave dhe rekomandimin e komisionit për shpërblim me kontratë. Duke pasur parasysh shkeljet e LPP-se dhe rregullave për prokurim publik qe kanë ndodhur gjatë vlerësimit të tenderëve në ketë aktivitet të prokurimit ,kërkojmë nga paneli shqyrtues që ta



shqyrtojë ankesën tonë me nr. 858/20, ta aprovojë si të bazuar, dhe në përputhje edhe me rekomandimin e ekspertit ta kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim për LOT 1. Me respekt.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Sallahu" SH.P.K-Kaçanik, se OE i rekomanduar nuk i plotëson kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, ku potencohet se në lotin 1. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE përveç pasjeve tjera në ofertë, i njëjti ka prezantuar edhe pajisje në emër të OE "Ekskavatori" të cilit kontrata i është dhënë në lotin 4, ku eksperti i ka bashkangjitur raportit si provë marrëveshjen e datës 13.07.2020.

Pretendimi tjetër i OE ankues "Sallahu" SH.P.K-Kaçanik ka të bëjë me punëtoret e deklaruar në ATK, përkatësisht potencohet se nuk janë prezantuar 30 punëtor. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ka aplikuar në grup/konzorcium dhe sipas deklaratave për punëtoret e prezantuar, rezulton që të dy anëtarët e grupit e mbulojnë kërkesën e AK-së, për minimumin 30 punëtoret e kërkuar. Përderisa lidhur me librezën e qarkullimit, sipas numrit të regjistrimit 05-492-AK, përmes kërkesës nuk është aplikuar si kërkesë nga AK, validiteti i qarkullimit rrugor, në të njëjtën librezë përshkrimi i automjetit është "automjet special", ndërsa tek lista e pasjeve të prezantuara përshkruhet edhe cisternë e ujit, për të cilin nuk mund të vlerësojmë nëse mjeti është cisternë e ujit apo jo.

Pretendimet tjera ankimore të OE ankues "Sallahu" SH.P.K-Kaçanik kanë të bëjnë kundër stafit profesional, përkatësisht kundrejt, znj Saxhide Ajdini, dhe Hajrulla Prenaj. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK përmes kërkesës së dosjes së tenderit për lot 1 dhe 7, kundrejt projekt menaxherit ka kërkuar variante të përvojës së punës 5 dhe 3 vite përvojë pune. Është kërkuar edhe staf tjetër me përvojë nga dy vite pas diplomimit. Znj. Ajdini, e kontestuar nga ankuesi rezulton që e njëjta studimet i ka përfunduar me datën 12 prill 2018, ku ka marr titullin Bachelor i ndërtimtarisë, programi studimor Konstruktiv. Për loti 1, AK kundrejt inxhinierëve ka kërkuar që të njëjtit si dëshmi dokumentare të prezantojnë CV, diplomë, kontratat e punës dhe referenca për punët e mëparshme. Kundrejt znj Ajdini, është prezantuar kopja e diplomës, kontratës dhe CV. Përderisa kundrejt z. Hajrualla Preniqi kopja e diplomës, me kualifikim bachelor i trafikut

rrugor dhe transportit, si dhe CV. Për të njëjtit nuk janë prezantuar dëshmi – Referenca për punët e kaluara siç është kërkuar nga AK.

Po ashtu, parashtruesi i ankesës “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik konteston edhe marrëveshjen e bashkëpunimit – Furnizim me beton të lidhur nga “Kema Company” sh.p.k me “Toni Compani” sh.p.k, përkatësisht kontestohet marrëveshja pasi që nuk posedon datë të lidhjes së marrëveshjes. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues se AK përgjatë vlerësimit të ofertave ka mundur të kërkoj sqarime në bazë të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, konsideron se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe të respektoj dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK - “KK-Prishtinë”;
- 1x1 OE - “Sallahu” SH.P.K-Kaçanik;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.